

Universiteti Politeknik i Tiranës shpall vendet vakante për pozicionet: “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm” dhe “Specialist i Auditit të Brendshëm”, pranë Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara më poshtë.

A. KRITERET DHE KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR PËRGJEGJËS SË SEKTORIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM

KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët që aplikojnë për pozicionin e **Përgjegjësit të Sektorit të Auditit të Brendshëm** duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Të kenë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë të studimeve në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;
- b) Të kenë 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion, nga të cilat jo më pak se 3 (tre) vite në fushën e auditimit të brendshëm;
- c) Të jenë të certifikuar dhe të kenë mbrojtur me dëshmi titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, sipas legjislacionit në fuqi.

B. KRITERET DHE KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR SPECIALIST TË SEKTORIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM

KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët që aplikojnë për pozicionin e **Specialistit të Auditit të Brendshëm** duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Të kenë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë të studimeve në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;
- b) Të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion;
- c) Të jenë të certifikuar dhe të kenë mbrojtur me dëshmi titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, sipas legjislacionit në fuqi.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jenë në gjendje shëndetësore që u mundëson ushtrimin e detyrës;
- c) Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- d) Të mos kenë masë disiplinore të largimit nga detyra.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Curriculum Vitae (CV);
3. Diplomë të arsimit të lartë dhe listën e notave, të noterizuara. Kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit duhet të paraqesin dokumentin e njohjes së diplomës nga institucioni përgjegjës;
4. Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës;
5. Dokumentacion që vërteton përvojën në punë;

6. Dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve dhe certifikimeve profesionale (nëse disponohen);
7. Raport mjekësor për aftësi në punë;
8. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarimi;
9. Dëshmi që vërteton certifikimin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

AFATI I APLIKIMIT

Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike të Universitetit Politeknik të Tiranës, brenda datës **24.06.2026**.